




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	27-03-2023	3	Viti god Year
Organ /Hjesta Organ /Jedinica Org./Unit	SKOPSHTICK	3025/2023	Sasia Kolicina Quantity
			113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.421/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.421/2023 të datës 24.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.03.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.421/2023 e datës 24.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në Komunën e Lipjanit, më datë 24.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2103/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 23.02.2023 me nr.1-400/01-7675 të organit të punësimit/Zyrës së Personelit të Komunës së Lipjanit lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) nga hyrja në fuqi e ligjeve të miratuara nga institucionet e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa Këshilli, me datë 20.03.2023 përmes emalit ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2807/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2103/2023 të datës 24.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 10.02.2023 për kompensimin në mënyrë retroaktive për pjesën e humbur të pagës; Përgjigje e datës 23.02.2023 lidhur me kërkesën e datës 10.02.2023; Akt emërimi i datës 02.04.2012; Vendosja e koeficientit sipas pozitës përkatëse-shkresë e datës 27.11.2014 nga DASHC/MAP-04/1571 02/Z58/3851; Kërkesë për përgjigje e datës 07.03.2023 me numër protokollit 2464/2023 dhe Përgjigje në ankesë e datës 20.03.2023 nga organi i punësimit me numër protokollit 2807/2023 bashkë me shkresat e lëndës;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Lipjanit në pozitën e punës Inspektor i Ndërtimtarisë. I njëjti më datë 08.12.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.1113/2022 të datës 08.12.2022 ka përfunduar procedimin administrativ lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga gjashtë (6) në tetë (8).

Ankuesi më datë 10.02.2023 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit për periudhën nga nëntori 2014 e deri më datën 31.01.2023. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 23.02.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 10.02.2023 me arsyetimin se Zyra e Personelit nuk është kompetent për ndryshimin e koeficientit, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë parashihen rregulla dhe kushte të tjera për përcaktimin e pagës.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 23.02.2023 të organit të punësimit, ankuesi me datë 24.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së dy koeficienteve të pagës në mënyrë retroaktive nga nëntori 2014 deri më datën 31.01.2023.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së dy koeficienteve të pagës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 02.04.2012 ka nënshkruar aktin e emërimit për pozitën e punës *Inspektor i Ndërtimtarisë* me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti deri më datë 08.12.2022 nuk ka ndërmarrë asnjë veprim administrativë me qëllim që të rregulloj çështjen që është objekt i këtij kontesti, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohen kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 30.10.2012), përkatësisht nenin 130 paragrafi 1 të këtij ligji ku përcaktohej se: "*Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin*".


Kolegji i Këshillit duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë për objekt çështjen e realizimit të retroaktivitetit sa i përket koeficientit të pagës, thekson edhe faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 dhe si rrjedhojë i njëjti ka hy në fuqi nga data 05.02.2023, për më tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil mbi të cilin e bazon edhe pretendimin e ankuesit në objektin e kësaj ankese ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar se gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohej çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Bazuar në at që u tha më lartë dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.


**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.421/2023, datë 27/03/2023

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit, \_\_\_\_\_
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

